

Me rastin e Asamblesë së pestë të Gjyqtarëve të EULEX-it, të mbajtur në Prishtinë më 10 korrik 2008,

Asambleja e përbërë nga këta gjyqtarë: Maria Giuliana Civinini, Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it; Guy Van Craen, Olavi Snellman, Andrea Cruciani, Angela Kaptein; Michael Zimmermann, Norbert Koster, Christine Lindemann-Proetel, Michael Simmons, Gerrit-Marc Sprenger; Gianfranco Gallo; Emilio Gatti.

Njëzëri miraton VENDIMIN

Për aprovimin e Udhëzimeve të MUK-së për MUK nga ana e Gjyqtarëve të EULEX-it.

Monitorimi, udhëzimi dhe këshillimi nga Gjykatësit e EULEX-it

Hyrje

Siç është cekur në pjesën 2.4 të Ligjit mbi Jurisdiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Alokimin e Lëndëve për gjykatësit dhe prokurorët e EULEX-it në Kosovë, “përpos ushtrimit të funksioneve të tyre juridike në pajtim me nenet 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, gjykatësit e EULEX-it do të monitorojnë, udhëzojnë dhe të këshillojnë gjykatësit kosovarë duke respektuar kështu parimet e pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe në pajtim me modalitetet e themeluara nga ligji aktual dhe nga EULEX KOSOVA.” Më tej, pjesa 3.9 dhe 5.6 e Ligjit mbi Jurisdiksionin u ofron gjykatësve të BE-së gjatë ushtrimit të funksioneve të monitorimit, udhëzimit dhe këshillimit autoritetin për qasje në fazat e procedurës, në kopje falas të dokumenteve dhe në kërkesë me shkrim për informata në lëndët e mbyllura apo që janë në vazhdim e sipër dhe që janë në jurisdiksion apo kompetencë të ndonjë gjykate në Kosovë, përfshirë edhe kërkesën për informata të mëtejme lidhur me ekzekutimin e vendimit përfundimtar apo vendime të tjera të gjykatës.

Ligji kosovar përfaqëson burimin ligjor, i cili ngarkon gjykatësit e EULEX-it me detyrën, *inter alia*, për të monitoruar, udhëzuar dhe këshilluar (MUK). Mirëpo, ligji i përmendur nuk ofron definicionin ligjor të këtyre funksioneve shtesë të gjykatësve të EULEX-it. Interpretimi sistematik i këtij ligji sjellë deri te përfundimi që monitorimi, udhëzimi dhe këshillimi përfaqësojnë tri fazat pasuese të një procesi tërësor, qëllimi i të cilit është asistimi dhe mbështetja e gjyqësorit kosovar për të kryer funksionet gjyqësore në pajtim me standardet evropiane dhe mënyrën më të mirë. Ç’është e vërteta, nuk është rastësi që Ligji mbi Jurisdiksionin nisë me funksionin e monitorimit, i cili është aktiviteti më i pabezdisshmi, pastaj vazhdon me fazën më të strukturuar të udhëzimit, në raste kur monitorimi ka shfaqë nevojën për veprime të mëtutjeshme, për të përfunduar më tej me ushtrimin formal të fuqisë këshillëdhënëse në raste kur përpjekjet paraprake për të garantuar respektimin e tërësishëm të standardeve evropiane kanë dështuar. Megjithatë,

këto tri funksione shtesë, të cilat nga perspektiva logjike dhe ajo teorike, do të mund të ndahen në tri hapa të veçantë dhe gradualë, janë mjaft të ndërlidhura, madje, ato edhe përforcojnë njëra-tjetrën. Prandaj, shihet që më të filluar procesi, gjykatësit e EULEX-it do të aplikojnë këto tri funksione në mënyrë simultane. Sipas së njejtës logjikë, duhet të ceket që funksionet e MUK-së veprojnë në mënyrë qarkore, gjë që do të thotë që këshillimi nuk e përmbyllë të gjithë procesin, i cili më pastaj kthehet sërish te faza e monitorimit. Pra, fjala është te një lloj zingjiri virtual, i cili ndërlidhë monitorimin, udhëzimin, këshillimin, funksionin ekzekutiv, monitorimin, etj. në gjithë procesin si tërësi.

Në nivelin operativ:

- 1) Sipas nevojës, gjykatësit e EULEX-it do t'i raportojnë Kryetarit të Asamblesë mbi aktivitetet e MUK-së;
- 2) Pastaj, sipas raportimeve të gjykatësve të EULEX-it, çdo gjashtë muaj Kryetari i Asamblesë do të dorëzojë propozimin mbi raportimin e aktiviteteve të MUK-së Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it;
- 3) Së fundi, Kryetari i Gjykatësve të EULEX-it do të dërgojë raportin e aprovuar mbi MUK-në në Zyrën Menagjuese të Programit të EULEX-it, raport i cili sipas Dokumentit për Implementimin e Programit, më tej do të dërgohet te Këshilli i Bashkimit Evropian. Qëllimi i këtij sistemi të raportimit është të bëhet një vlerësim i funksionimit të gjyqësisë kosovare, vënë kritere reference dhe duke përpiluar strategjitë e ardhshme. Qëllimi përfundimtar është të krijohet një system i integruar vlerësimi. Ç'është e vërteta, një ndër qëllimet afatgjata të EULEX-it është që të krijohet një process i qartë, i drejtë dhe demokratik i vlerësimit, i cili garanton raportim anonim, transparencë sa i përket kriterit të vlerësimit, burime informatash dhe indikatorë kualitativ për gjyqësinë;
- 4) Çdo gjashtë muaj, Kryetari i Gjykatësve të EULEX-it do të jetë përgjegjës për t'i dërguar Zyrës Menagjuese të Programit të EULEX-it, një raport mbi ushtrimin e fuqisë ekzekutive për zëvendësimin e gjykatësve kosovarë me ata të EULEX-it dhe anasjelltas.

Gjithashtu duhet të ceket se gjatë tre muajve të parë tranzitiv, MUK-ja nuk do të lidhet me funksionet ekzekutive gjyqësore. Si pasojë, vetëm pas kësaj periudhe transitive, MUK-ja do të ushtrohet plotësisht atëherë kur është paraparë që EULEX të ushtrojë fuqinë ekzekutive. Ç'është e vërteta, funksionet e MUK-së janë të lidhura ngusht me ushtrimin e funksioneve ekzekutive.

Në të vërtetë, Kryetari i Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it mund të përdor rezultatet e procesit të MUK-së për të miratuar vendimet e duhura për zëvendësimin e gjyqtarëve kosovarë me ata të EULEX-it dhe anasjelltas. Kësisoj, pa ndërhyrë në procedurat e zotëruara nga vendorët, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të ushtrojë fuqinë e zëvendësimit, e cila mund të reflektojë bashkëveprimin (pozitiv apo negativ) ndërmjet procesit të MUK-së dhe bashkëpunimin dhe përpjekjeve të demonstruara nga gjykatësit vendorë si pasojë e këtij procesi.

MONITORIMI

Monitorimi nënkuptohet si vëzhgimi, vlerësimi dhe raportimi mbi kryerjen e funksioneve përkatëse gjyqësore për identifikimin e përmirësimeve të mundshme. Në veçanti, monitorimi përbëhet nga vëzhgimi dhe skanimi i kryerjes së detyrave të gjykatësve vendorë në mënyrë që të mund të identifikohen fushat që kanë nevojë për akoma më shumë mbështetje për të plotësuar standardet ndërkombëtare dhe evropiane, udhëzimet, praktikat më të mira të punës dhe kriteret e referencës.

Monitorimi nuk nënkupton ushtrimin e kontrollit individual apo ndonjë lloj tjetër mbikqyrje e mënyrës sesi funksionojnë gjykatat kosovare.

Monitorimi do të ekzekutohet në një mënyrë jo-diskriminuese dhe me respekt të plotë ndaj pavarësisë së gjykatësve të Kosovës bazuar në parimet e nderimit reciprok dhe barazisë. Monitorimi nuk kërkon rishqyrtim apo kritikë ndaj punës së kryer nga gjykatësit vendorë. Qëllimi i kësaj teknike është vlerësimi i drejtë dhe i paanshëm i efikasitetit të gjyqësisë në Kosovë gjatë aplikimit të parimit përkatës të drejtësisë dhe standardeve ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.

Gjatë ushtrimit të këtij qëllimi, gjykatësit e EULEX-it do të bashkëndajnë përvojën dhe të bashkëpunojnë me kolegët e tyre vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët kanë punuar në monitorim të gjykatave siç janë KJK-ja, OSBE-ja, USAID-i, KB-ja dhe Ombudspersoni.

Është gjithashtu e rëndësishme që t'u ipet kolegëve vendorë një rol aktiv në procesin e monitorimit. Ata duhet nxitur për të shprehur mendimet e tyre mbi të metat dhe mungesat në gjykatë dhe ato në gjyqësi në përgjithësi dhe mendimet mbi mënyrat sesi mund të përmirësohet situata.

Veç kësaj, procesi i monitorimit nuk duhet të nënkuptohet si mundësi shtesë që palët e pakënaqura të apelojnë kundër vendimit të gjykatës për çështjet e tyre.

Gjithashtu duhet të jetë e qartë që qëllimi i monitorimit nuk nënkupton hetimin e sjelljes së keqe disiplinuese apo kriminele të gjykatësve vendorë. Në rastet e rralla të vëzhgimit të sjelljes së tillë gjatë monitorimit, gjykatësi i EULEX-it nuk do të ndërmarë ndonjë hap, por do të informojë autoritetet kompetente vendore disiplinuese ose ndjekëse.

Gjykatësit e EULEX-it do të kryejnë monitorimin bazuar në standardet e qarta dhe bashkarisht të aplikueshme ndërkombëtare dhe evropiane, në udhëzimet, në praktikat më të mira të punës dhe kriteret. Sa i përket këtij aspekti, Doracaku i 2003-tës mbi të Drejtat e Njeriut në Administrimin e Drejtësisë, botuar nga OHCHR-ja, mund të shërbejë si mjet i dobishëm ngaqë me jurisprudencën ndërkombëtare relevante, është i bazuar në burimet kryesore të ndërlidhura me të Drejtat e Njeriut në sektorin e drejtësisë (për shembull, 1950 ECHR; 1966 ICCPR; 1985 Parimet Bazë në Pavarësinë e Gjyqësisë).

Lista e parë më e detalizuar e sektorëve të sistemit kosovar gjyqësor, i cili do të monitorohet nga gjykatësit e EULEX-it, mund të gjendet në Dokumentin për Zbatim të Programit edhe pse do të merret parasysh ndryshimi ndërmjet përfundimit të Monitoruesit dhe Raportit për Menagjim të Programit (për të verifikuar përmbushjen e qëllimeve të misionit) dhe përfundimit të monitorimit (dhe raportimit) të gjykatësve të EULEX-it (për

të zbuluar nevojat për monitorim dhe këshillim dhe për të parë përmirësimin e kualitetit të gjyqësisë).

Disa nga fushat që mund të kërkojnë vëmendje të posaçme gjatë procesit të monitorimit mund të jenë:

- Sistemi për alokim të lëndëve;
- Sistemi për pakësimin e padive të vjetra;
- Shpërndarja e punës;
- Programi për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- Qasja në gjykatë,
- Mungesa e korrupsionit dhe diskriminimit;
- Respektimi i kohës së arsyeshme për të marrë vendime;
- Ekzekutimi apo zbatimi i vendimeve gjyqësore (penale), dënimit me burgim dhe gjobat;
- Recidivizmi, d.m.th. mënyra sesi gjykatësi apo paneli mund ta kuptojë që i dyshuari apo i pandehuri është dënuar me burg apo me ndonjë sanksionim tjetër (gjobë apo ndonjë tjetër alternativë);
- Hetime të vazhdueshme ndaj të njejtit të dyshuar apo të pandehur në një rajon tjetër.
- Me çfarë mekanizmi (poqese ka diçka të tillë) mund t'i kumtohen gjykatësit në gjykatën komunale apo në atë të qarkut vendimet e Gjykatës Supreme në çështjet e tij apo në çështjet në përgjithësi.

Sidoqoftë, pa u futur më thellë në lëndët që kërkojnë aktivitete monitorimi, një analizë dhe sintezë e raporteve të monitorimit, të nxjerra nga organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë edhe OJQ-të, mund të jetë e dobishme.

Një grup punues (GP), i përbërë nga gjykatësit e EULEX-it, do të themelohet me qëllim të studimit dhe përpilimit të një sinteze nga raportet e OSBE-së, UNDP-së, USAID-it, HRW-së, Amnesty International, institucioneve të Ombudspersonit dhe të Inspektimit, Këshillit të Evropës dhe të tjera. Sinteza do t'u ofrojë gjykatësve të EULEX-it (dhe kolegëve vendorë) një pamje të qartë të aktivitetit të vazhdueshëm të monitorimit (metodat, burimet e informatave, bazën ligjore, rezultatet, masat rrjedhëse), shënjestra e të cilit është gjyqësia kosovare dhe që e shmangë mundësinë që ne të sjellim një raport të ngjashëm me ato të organizatave të tjera monitoruese.

GP-ja do të propozojë (deri në fund të gushtit) disa rekomandime lidhur me fushat në të cilat udhëzimet e EULEX-it do të përqëndrohen.

Aktiviteti i tillë për të përcaktuar “subjektet interesante” për të monitoruar dhe mjetet që na nevojiten do të realizohen në konsultim me gjykatësit kosovarë. Një takim me Kryetarin e Gjykatës Supreme, kryetarët e gjykatave të qarkut dhe një përfaqësues të gjykatësve, do të caktohet në fillim të shtatorit. KJK-ja dhe IJK-ja do të jenë të përfshirë në këtë proces.

Në princip, monitorimi do të kryhet nga gjykatësit e EULEX-it në gjykatën e njëjtë të qarkut ku ata ushtrojnë funksionet e tyre ekzekutive. Në rrethana të veçanta, Kryetari i Asamblesë së Gjykatësve të EULEX-it mund të vendosë të emërojë një apo dy gjykatës të EULEX-it të Gjykatës së Qarkut që të monitorojnë një apo dy lëndë në gjykatën tjetër të qarkut.

Është kuptuar se kualiteti i monitorimit të aktivitetit të gjykatave dhe i standardeve të dëshiruara të kualitetit të dënimeve ka nevojë për program vlerësues sistematik (kjo mbetet qëllim për misionin e kjo kërkon zgjedhje të hollësishme në aspektin e përshtatshmërisë të aktiviteteve gjyqësore dhe zgjedhjeve e kritereve kualitative), një mori burimesh mund të shfrytëzohen:

- Statistikat mbi kërkesat për diskualifikim
- Statistikat mbi kërkesat për ndërrimin e gjykatësit Kosovar me një gjykatës të EULEX-it
- Statistikat e ankesave
- Statistikat në nivel të gjykatave
- Statistikat mbi anulimin e dëgjimeve (anulimet paraprake dhe anulimet gjatë dëgjimit)
- Statistikat mbi numrin e dëgjimeve për lëndë
- Statistikat mbi kohën e shqyrtimeve
- Statistikat mbi përqindjen e apelimeve
- Statistikat mbi përqindjen e vendimeve të përmbytura
- Vetëvlerësimi nga ana e gjykatësve Kosovare
- Analiza e mediave
- Vlerësimi i gjykatësve të EULEX-it mbi procesin (veprim i hapur dhe transparent, garantimi i të drejtave të mbrojtjes, pavarësi dhe paanshmëri, organizimi i mirë i punimeve, efikasiteti, iniciativë veprimi, publicitet, fleksibilitet), e marrjes së vendimit (i bazuar në ligj, transparent, motivim sistematik, i kuptueshëm), në trajtimin e palës dhe publikut, në kompetencat e gjykatësve (pjesëmarrje aktive në aktivitetet e trajnimeve dhe në mbledhjet periodike me kolegët e tyre evropianë, informacionet, specializimet), mbi udhëheqësinë.

Në lidhje me këtë dhe në përputhje me Ligjin mbi Jurisdikcionin si dhe me Marrëveshjen në mes të Kryetarit të Asamblesë, Kryetarit të Gjykatës Supreme si dhe Kryetarëve të Gjykatave të Qarkut, lidhur më datën 5 qershor 2008, “gjykatësit e EULEX-it do të kenë autorizimin për qasje, së bashku me personelin ndihmës të EULEX-it (p.sh. zyrtari ligjor, përkthyesi, etj.) në çdo fazë të lëndës civile apo penale që është në shqyrtim apo e mbyllur, të marrin kopjet e lira të dokumenteve dhe dosjeve, dhe të kërkojnë me shkrim informata lidhur me çështjet civile ose penale, në shqyrtim apo të mbyllura dhe që janë në jurisdikcionin e të gjitha gjykatave në Kosovë, pavarësisht caktimit të tyre në lëndë”.

Qasjet e gjykatësve të EULEX-it në informata, dosje dhe në seanca të lëndëve civile apo penale që janë në vijim apo të mbyllura gjithmonë do të ndodhin në konsultim me kryetarin e gjykatës përkatëse.

I vetmi qëllim i së drejtës së gjykatësve të EULEX-it për qasje në lëndë është për të verifikuar mbarëvajtjen e tyre.

Gjykatësit e EULEX-it nuk do të caktohen në lëndët në të cilat ata janë të përfshirë si monitorues.

Raportet e gjykatësve të EULEX-it duhet të jenë përshkrime të fushave të mundshme për përmirësime dhe shkeljeve të përsëritura të standardeve të përmendura dhe praktikave më të mira të punës, pa referim të ndonji gjykatësi të mundshëm vendor përgjegjës për shkeljet. Për më shumë, raportet mendohen të jenë absolutisht konfidenciale në këtë fazë, në kuptimin se ato kanë të vetmin funksion që të krijojnë dhe modelojnë aktivitetin pasues të monitorimit. Raportet nuk duhet të jenë në dispozicion të homologëve vendorë, meqë ato shërbejnë vetëm si mjete për gjykatësit e EULEX-it që të modelojnë aktivitetin e udhëzimit, duke u përqëndruar vetëm në lëndët që dalin nga raportet.

UDHËZIMI

Nëse monitorimi ka zbuluar zbrazëtira dhe shkelje të përsëritura të standardeve ndërkombëtare dhe evropiane ose hapësira të mundshme për përmirësim, gjykatësit e EULEX-it duhet të fillojnë, bazuar në raportet konfidenciale të monitorimit, aktivitetin e udhëzimit.

Udhëzimi përfshin trajnimin, duke treguar se si duhet sjellur me detyra specifike, duke ndarë “përvojën”, inkurajimin. Udhëzimi është ndihmë informative, e bazuar në besimin e ndërsjellë dhe respektin profesional, të ndihmojë homologët vendorë që të mbështesin detyrat e tyre sa i përket funksioneve gjyqësore në pajtim me standardet evropiane. Veç kësaj, udhëzimi do të thotë bashkëpunimi me gjykatësit vendorë në atmosferë besimi, profesionalizmi bazuar në respektimin e ndërsjellë. Të analizojnë së bashku me ta problemet që kanë të bëjnë me gjykatën dhe administrimin e lëndës, caktimin e lëndës dhe alokimin, ti definojnë këto probleme dhe të gjejnë - udhëzojnë për të gjetur zgjidhjet. Në lidhje me këtë, puna në panele të përziera vë në pah mënyrën e mësimit dhe udhëzimit bazuar në kopjim. Mendimi i gjykatësve të EULEX-it duhet që të diskutohet në baza të dinjitetit të secilës lëndë, nëse kjo kërkohet nga një gjykatës vendor ose në panelin e përzier, gjatë fazës para gjykimit ose gjatë gjykimit. Puna e zakonshme studimore ofron mundësi të madhe për gjykatësit vendorë që të japin informata të çmuara në diskutimet rreth interpretimeve të dispozitave relevante ligjore.

Udhëzimi do të ushtrohet nga ana e gjykatësve të EULEX-it në mënyrë të pranueshme nga ana e gjykatësve vendorë. Kjo mund të bëhet përmes aktiviteteve në vijim: trajnimi (ndarja e përvojave sa i përket zbatimit të detyrës së veçantë), lehtësimi (krijimi i mundësive për gjykatësit vendorë të zbatojnë teknika të reja), këshillime (ndihma gjykatësve vendorë që të studiojnë pasojat e vendimeve të mundshme) dhe ofrimi i rrjetit (referimi i gjykatësve vendorë te kolegët tjerë vendorë dhe ndërkombëtarë që kanë më shumë përvojë në lëndët ose çështjet e ngjajshme). Udhëzimi gjithashtu mund të përfshijë: shkëmbimin e përvojave, informatave, mendimeve; bazuar në burimet e duhura

ligjore ose eseve doktrimore apo jurisprudencës ndërkombëtare: organizimi, së bashku me aktorët kompetent ndërkombëtarë (siç është OSBE-ja ose Komisioni European apo TNKLJU ose Ministria e Drejtësisë), programe trajnimi të shkurtëra dhe të qarta ose visita studimore jashtë vendit.

Veçantërisht gjatë trajnimit të gjykatësve vendorë, duhet të ceket që edhe pse monitorimi dhe udhëzimi nuk janë aktivitete thjeshtë për ndërtimin e kapaciteteve, ato janë të lidhura ngushtë me ndërtimin e institucioneve. Mbase, një ndër mësimet më të rëndësishme të mësuarra gjatë përvojave në misionet është plotësueshmëria esenciale ndërmjet monitorimit-udhëzimit për të drejta të njeriut dhe ndërtimit të institucioneve. Ç'është e vërteta, qëllimi i monitorimit dhe udhëzimit është që të hetohet dhe të verifikohet nëse gjykatat vendore funksionojnë në mënyrë të duhur dhe të kuptohen pikat e forta dhe të dobëta të sistemit të drejtësisë. Bazuar në aktivitetet e sigurta të monitorimit dhe udhëzimit, projektet për ndërtim kapacitetesh do të bazohen në kuptimin tërësor të praktikës së punës, përfshirë këtu edhe pikat e vazhdueshme të dobëta dhe problemet. Së fundi, monitorimi dhe udhëzimi në terren ofron reagime të drejtëpërdrejta ndaj efikasitetit të strategjive dhe programeve reformuese gjatë zbatimit të tyre. Pra, programet e trajnimit duhet të sjellin rezultatet si në vijim: të zhvillohen aftësitë e nevojshme praktike dhe të fitohet dijenia e duhur për të shkarkuar në mënyrë efikase funksionet juridike për të lehtësuar bashkëveprimin ndërmjet akterëve të sektorëve të ndryshëm të drejtësisë, për të sjellë besimin, respektin e ndërsjellë dhe bashkëpunimin operativ ndërmjet degëve të ndryshme të sistemit penal të drejtësisë dhe për të përpiluar rekomandime mbi integritetin publik dhe kodin e sjelljes.

Udhëzimi gjithashtu mund të përfshijë përpilimin e listave të plota dhe shablloneve për procedurat gjyqësore. Shabllonet e reja mbi vendimet dhe masat e tjera gjyqësore, të përpiluara nga gjykatësit e EULEX-it dhe ato të vjetra të përpiluara nga gjykatësit vendorë duhet të rishqyrtohen dhe haptazi të diskutohen në mënyrë që të krijohen standarde të përbashkëta për shabllonet e tilla. Gjithashtu duhet të ketë edhe diskutime të hapura mbi dispozitat e KPPK-së dhe aplikimeve të tyre në gjyq. Udhëzimi përfshin edhe këshilla mbi interpretimin e dispozitave relevante ligjore në pajtim me të menduarit e logjikshëm dhe të mirë ligjor dhe bazuar në komentet dhe mendimet ligjore gjyqësore.

Sistemi i të mësuarit bazuar në nënshtrimin nuk është për t'u aplikuar. Aktivitetet e udhëzimit ndodhin gjatë marrëdhënies së paritetit, pra marrëdhënieje "në mes kolegësh". Mënyrat e të mësuarit – tipike për sistemin shkollor, të bazuara në dëgjueshmërinë dhe në imponimin e rregullave dhe marrëdhënieve asimetrike gjithësesi duhen përjashtuar. Mënyra më e mirë për të arritur diçka të tillë është të ndërlidhemi dhe të kuptohemi me kolegët tanë vendorë. Ç'është e vërteta, në të kaluarën, kolegët tanë vendorë kanë shprehur kritikë ndaj gjykatësve ndërkombëtarë duke thënë se këta të fundit kanë pasur tendenca t'u ulin atyre efektin.

Është më se e rëndësishme që gjykatësit evropianë procesi gjatë procesit të udhëzimit të demonstrojnë:

- profesionalizëm
- vëmendje

- sensibilitet
- sjellje etike
- angazhim në një marrëdhënie nga e cila që të dy palët mësojnë nga njëra-tjetra

Kualitetit i drejtësisë dhe vendimeve ligjore nuk mund të rritet pa pasur “mjetet e duhura për diçka të tillë.” Në rastin e aktivitetit të udhëzimit, mjetet e duhura janë:

- teknikat dhe metodat e punës
- përmirësimi i vetes dhe metodat për të mësuar veten
- ligjet
- jurisprudenca vendore
- vendimet gjyqësore evropiane ndërkombëtare
- lënda-ligji
- praktikat më të mira të punës
- literatura shënkore

Takimet gjyqësore me pjesëmarrjen e gjykatësve vendorë dhe atyre të EULEX-it do të organizohen rregullisht në mënyrë që të shkëmbehen mendimet dhe praktikat më të mira të punës.

Aktiviteti udhëzues gjithashtu duhet të prodhojë raporte, të cilat, edhe njëherë, do të referohen institucioneve si të tilla (dhe jo individëve) dhe do të mbahen në mënyrë konfidenciale ngase qëllimi i tyre i vetëm është ndërmarrja e hapave të mëtejme, pra këshillimi.

KËSHILLIMI

Nëse monitorimi dhe udhëzimi nuk korrën sukses në kuptimin që disa shkelje të vazhdueshme apo mosfunksionime strukturale vazhdojnë të ndodhin edhe pas zbatimit të aktiviteteve të lartpërmendura, hapi i fundit që duhet të ndërmerret nga gjykatësit e EULEX-it është këshillimi.

Këshillimi ka tendencë të ofrojë këshilla profesionale autoriteteve kompetente (MD-së, KKJ-së, IJK-së, Kryetarit të Gjykatës, Gjykatës Supreme, Parlamentit, organeve gjyqësore) në çdo temë të dalë nga përvojat e montiorimit dhe udhëzimit. Këshillimi përbëhet nga metodat formale dhe kolektive të gjykatësve të EULEX-it në Asamblenë e Gjykatësve të EULEX-it, të kumtuara në mënyrë zyrtare nga Kryetari i Gjykatësve të EULEX-it autoriteteve kompetente juridike, legjislativë apo administrative në mënyrë që të aktivizohen masat dhe mjetet e nevojshme. Këshillimi u drejtohet institucioneve vendore si i tillë dhe jo homologëve individualë. Këshillimi u ofron akterëve kosovarë mendime dhe ide të nevojshme për të intervenuar në fushat e sistemit të drejtësisë, fushat për të cilat është dëshmuar që kanë nevojë për përmirësim.

Si shembull, nëse mosfunksionimi i vazhdueshëm në sistemin e drejtësisë në Kosovë varet nga niveli i ulët i pagave të gjykatësve vendorë apo në pjesëmarrjen e tepërt të gjyqtarëve porotë, në pajtim me atributet kushtetuese, gjykatësit e EULEX-it mund të

këshillojnë dhe të mbështesin Parlamentin e Kosovës për të përpiluar ligje të reja të cilat kontribuojnë në tejkalimin e mosfunksionimeve të lartëpërmendura.

Maria Giuliana Civinini

Kryetare e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it